



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E LIPJANIT  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Priljeno: 27. 07. 2023		
Njësia Jednica:	Numri Broj:	Shtojca Dodatak:
05-453/01-38765		



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, 27.07.2023

### THIRRJE PUBLIKE PËR OJQ – të

#### Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve *Avancimin i SPORTIT në Komunën e Lipjanit*

1. **Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport** bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare (Klubet sportive) të Regjistruara në Republikën e Kosovës që Selin dhe adresen e Klubit apo Shoqates e kanë në teritorin e Komunës së Lipjanit që programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e *Sportit dhe rekreacionit* të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në *Avancimin i SPORTIT në Komunën e Lipjanit*

2. OJQ-të (Klubet Sportive) në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat prioritare në vijim:

2.1. Klubet sportive të cilat bëjnë gara zyrtare në Federatat përkatëse të licencuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

3. Organizatat jo-qeveritare (Klubet Sportive) mund të aplikojnë me një projekt përmes aktiviteteve si më poshtë:

Aktivitetet që kanë për qëllim nxitjen e autoriteteve lokale, institucionet publike dhe akterëve tjerë për bashkëpunim me shoqërinë civile në promovimin e aktiviteteve sportive dhe zbulimin e talentëve të rinj.

Aktivitete që synojnë avancimin e politikave lokale dhe qeveritare në fushën e avancimit dhe promovimit të sportit

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 70,000.00 euro.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është 1,000.00 euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 20,000.00 euro.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 17.08.2023.

6. OJQ-të (Klubet sportive) mund të aplikojnë me më së shumti me një (1) projekte në kuadër të kësaj thirrje,

7. Klubet sportive të cilat kanë Kontrata të hapura dhe të pa aryetuara nuk kanë të drejtë të aplikojnë.

Periodha e zbatimit të projektit është për 6 muaj.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare (Klubet sportive) me Seli dhe Adresë në Komunën e Lipjanit Republikën e Kosovës së paku *dy (2) vite* para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e *Sportit*.

OJQ-të (Klubet Sportive) duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale *ndaj ofruesit të mbështetjes financiare* dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ nuk është nën hetime për vepra penale,

8. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të *ofruesit të mbështetjes financiare (web faqen [www.komunaelipjanit-rks.org](http://www.komunaelipjanit-rks.org))*.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

## **KOMUNA E LIPJANIT**

**Rruga „Shqipëria”**

**Zyra për shërbim të qytetarëve**

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike*.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

9. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: *{e-mail adresen [bekim.zaskoku@rks-gov.net](mailto:bekim.zaskoku@rks-gov.net)}*

Vërejtje : sqarimet lidhur me Thirrjen, kushtet, kriteteret I gjeni në web faqen e publikuar më lartë.

Anila Reçica Llugiqi

Drejtoreshë e DKRS-së

